



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 07, datë 27.04.2018

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:**  
**“NDËRTIMI I LINJËS SË SHPËRNDARJES 10KV PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI TË**  
**FSHATRAVE GJINIKAS, OSOJE, KODRAS, PROTOPAPË, PESHTAN, ME**  
**VENDODHJE NË BASHKINË KORÇË DHE BASHKINË MALIQ”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Ndërtimi i linjës së shpërndarjes 10kv për furnizimin me energji të fshatrave Gjnikas, Osoje, Kodras, Protopapë, Peshtan, me vendodhje në Bashkinë Korçë dhe Bashkinë Maliq”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Korçë dhe Bashkisë Maliq.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
LEDIA TOTA

